E martë, 20 qershor 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

[I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem thërrisni çështjen, paraqisni çështjen.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mirëmëngjes. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mirëmëgjes, të gjithëve.

Për procesverbal, them që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit me përjashtim të z. Krasniqi, që na ndjek me videolidhje.

Përpara sesa të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 03811, Trupi Gjykues do të vendosë lidhur me dokumentin i cili u paraqit dje.

Pas diskutimeve të ditës së djeshme, Trupi Gjykues urdhëron që dokumenti ERN 113511 deri në 113522 të pranohet në procesverbal të pranohet si provë materiale.

Znj. Sekretare, ju lutem caktoni numrin e provës materiale për këtë dokument.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, numrin që i kemi dhënë dje këtij dokumenti është P196, por tani statusi i dokumentit do të ndryshohet, pra, do jetë një provë materiale e pranuar nga Trupi Gjykues.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Dëshmitari 03811 tani po futet në sallë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, mirëmëngjes. Më dëgjon?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Mikrofoni çaktivizuar].

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase nuk i është ngritur zëri. Dëshmitar, më dëgjon? Më dëgjon?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa të fillojmë dua t'ju them që ekipet e Mbrojtjes e kanë shkurtuar kohën për t'ju marrë në pyetje në më pak sesa dy orë. Kështu që ne parashikojmë që dëshminë tuaj ta përfundojmë sot përpara drekës.

Ju kujtoj që ju lutem mundohuni që të jepni përgjigje të qarta pyetjeve, me fjali të thjeshta.

Nëse nuk e kuptoni pyetjen kërkojeni Avokatit që ta

përsërisë edhe njëherë pyetjen.

Po ashtu, ju lutem, mos harroni të thoni se cila është baza e njohurive që keni dhe rrethanat që lidhen me pyetjen që ju bëhet.

Ju kujtoj që keni përsëri detyrimin që të thoni të vërtetën sikurse e thatë dje në deklaratën solemne.

Gjithashtu, ju lutem flisni përpara mikrofonit prisni pesë sekonda përpara sesa të jepni përgjigje pyetjes dhe flisni ngadalë në mënyrë që përkthyesit t’ju kapin.

Nëse keni nevojë të bëni pushim, na thoni dhe ne do bëjmë organizimet e nevojshme.

Z. Pace, a dëshironi që të kalojmë në seancë private tani?

Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do bëjmë pushim deri në orën 11.30.

Megjithatë kur të kthehemi do ju kërkoja që të më thoni sesa kohë do ju nevojitet për kundërpyetje. Pra, do t'ju kërkoj që ta thoni vlerësimin sa kohë ju duhet për të bërë kundrapyetjet tuaja, kur të kthehemi përsëri, për procesverbal.

Do mblidhemi përsëri në orën 11.30 pas pushimit të kafes.

--- Pauza fillon në orën 11.03

--- Seanca rifillon në orën 11.31

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë duke e filluar me Mbrojtjen e z. Thaçit, a keni ndonjë informacion sa do të zgjasë kundër pyetja për dëshmitarët?

Z. KEHOE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë se e kisha të fikur mikrofonin.

Dëshmitarët që do jenë të planifikuar për më pas, janë dëshmitarë shumë të rëndësishëm për këtë çështje gjyqësore, kështu që do të qëndrojmë në të njëjtat afate kohore. Në të njëjtat kohë, pra, që kemi parashtruar më përpara, sa i takon kundër pyetjeve të tyre. Dhe z. Misetiç në fakte do të marrë në pyetje disa prej tyre, kështu që i qëndrojmë vlerësimit që kemi dhënë më përpara lidhur me dëshmitarët që planifikohen më pas.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Për dëshmitarin 4746, parashikojmë tre orë. Për dëshmitarët 4290, tre orë. Të dy këta dëshmitarë kanë një farë domethënie, një farë rëndësie. Ndërkohë që sa i takon dëshmitarit 4337 planifikojmë gjysmë

ore. Ndërkohë që jam në këmbë, a mund të them që nëse jepni leje ju, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues, z. Veseli do të pëlqente që të ndiqte procesin gjyqësor nesër, në konferencën për ecurinë e çështjes, me videolidhje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, në qoftë se do ta bëjmë për nesër. Megjithatë, mund ta bëjmë erdhe sot pasdite. Kështu që le të shohim se si do vijohet.

Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit. U konsultova me z. Roberts, sa i takon vlerësimit të kohës për kundërpyetjet tona, pak a shumë është e njëjta gjë që kemi parashikuar edhe më përpara. Për dëshmitarin 4337, parashikojmë tre orë. Dëshmitari 4746, tetë orë, dëshmitarin 4290 shtatë orë, dhe dëshmitarin 2161, katër orë.

Vazhdojmë me përgatitjet tona de në qoftë se kemi ndonjë ndryshim të kohës së planifikuar paraprakisht, do të njoftojmë.

Z. ELLIS: [Përkthim] Sa i takon dëshmitarit 4331, ne e kemi ulur vlerësimin e kohës për kundër pyetje për këtë dëshmitar nga dy orë, në një. Sa i takon dy dëshmitarëve të tjerë, për 4290 dhe 4746, koha që planifikojmë vazhdon që të mbetet i njëjti vlerësim që kemi bërë më përpara, duke marrë parasysh atë çfarë do të dëshmohet prej këtyre dëshmitarëve.

Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, Z. Pace?

Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se na -- e merrni parasysh

këtë gjë, do të ishte mirë që të qartësohet se cili është vlerësimi i kohës së tyre sa i takon ekipeve të Mbrojtjes për të njëjtin dëshmitar, sepse ndërkohë do të duhet që të thuhej se cili prej ekipit të Mbrojtjes ndoshta në vlerësimin tuaj -- dhe ky mund të jetë informacion i rëndësishëm për juve. Pra të thoni se cilët do të jenë personat që do të marrin në pyetje dëshmitarët.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Besoj se e kanë marrë parasysh, megjithatë dua t'ju pyes edhe një herë, në qoftë se e keni marrë parasysh edhe vlerësimin e ekipeve të tjera vlerësuese, ose pyetse.

Po, faleminderit. Ju lutem na përditësoni, na përditësoni përditë edhe në qoftë se ka ndryshime të vlerësimeve tuaja sepse do të na ndihmonte më mirë për të planifikuar në mënyre më efektive.

Jemi në seancë publike, ndërkohë që dua që të kalojmë në seancë private, znj. Sekretare, ndonjëherë qoftë se z. Kehoe vazhdon që t'i qëndroje të njëjtit mendim, pra që duhet që të qëndrojmë në seancë private.

Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, duhet të qëndrojmë në seancë private sepse do të bëjmë edhe disa pyetje shumë personale tani.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjatë drekës do ju çoj një listë me pika për diskutim. Nëse kemi mundësi sot mbasdite, që duket në fakt se do të kemi, do të diskutojmë sot lidhur me pikat që kanë nevojë të shtjellohen më tej, kështu që të mos takohemi nesër. Në qoftë se ndonjë prej të akuzuarve dëshiron të kthehet në objektin e paraburgimit është krejt OK prej ne, mjaft që të na njoftoni paraprakisht.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.07

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, sillni dëshmitarin. Thashë znj. Sekretare, në fakt e kisha fjalën "z. Sekretar".

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të ndërpresim edhe sistemin për ndryshimin e zërit.

Me këtë mbyllim edhe seancën e ditës së sotme. Do të rimblidhemi më 10 korrik me dëshmitarin e radhës dhe tani të diskutojmë çështjet që diskutuam shkurtimisht sot paradite.

Sikurse dhe folëm dje, Trupi Gjykues dëshiron të shtjellojë disa nga hapat që mund të marrin palët dhe Trupi Gjykues që të kemi seanca sa më publike. Kemi para parashtrimet me shkrim që na keni dërguar të gjithë ju. I kemi marrë në shqyrtim të gjitha këto parashtrime.

Disa gjëra i kemi menduar edhe ne, i kemi diskutuar me njëri-tjetrin. Është e rëndësishme të theksojmë dhe të pajtohemi që seancat të jenë sa më publike të jetë e mundur. Por ama është e vështirë, është e vështirë. Kështu është situata. Ndonjëherë redaktimet janë të tepërta; ka fjali që janë shumë të vështira t'i lexojmë. Të gjitha, e zezë [sipas përkthimit], e zezë [sipas përkthimit] thuhet shkoj në e zezë [sipas përkthimit], ora kaq e zezë [sipas përkthimit]. Nuk kanë asnjëfarë kuptimi.

Për mua kryesorja është që para se të marrim dëshmitarin tjetër, për të dhënë dëshmi, të gjitha redaktimet të rishikohen dhe të shohim pastaj sa seanca mund të kemi publike dhe sa seancë private dhe kjo është një aspekt që duhet trajtuar. Unë ju dërgova diçka në pushimin e drekës; ju thashë të më jepni mendimin tuaj; ne do t'i marrim parasysh sugjerimet dhe përfundimisht ne do marrim dhe vendimin përkatës.

Numër një, të gjithë pajtohemi që duhet të përpiqemi të

kemi sa më shumë seanca publike në këtë proces gjyqësor. Duhet që shumica e dëshmive të dëgjohen nga publiku. Po ka sigurisht edhe dëshmi që mund të dëgjohen në seanca private, por e mira është që këto të grupohen bashkë.

E kemi thënë, jemi përpjekur. Herë të tjera e kemi harruar fare. Nuk e di pse nuk i grupojmë dot dëshmitë, pavarësisht se kush është dëshmitari, të përpiqemi që të kemi njëfarë strukturimi. Pra, ato që kemi private, për shkak të materialeve të mbrojtura, të përpiqemi t'i bëjmë në një grupim dhe pjesët e tjera t'i bëjmë në një moment të dytë. Sepse këtu përfshihen edhe redaktimet, prandaj. Ju keni përvojë, ju e dini dhe të shohim cila mund të jetë zgjidhja për këtë aspekt që sapo ngrita. Dhe do t'i drejtohem fillimisht Prokurorisë.

Z. Quick.

Z. QUICK: [Përkthim] I kuptojmë shumë mirë shqetësimet tuaja. Problemi është kur përgatisim pyetjet, ne si Prokurori, janë disa nga shqetësimet që sapo paraqitet dhe ju në fakt, që është Mbrojtja, sikurse duket edhe nga redaktimet që kemi bërë në kërkesat përkatëse dhe vendimet që keni dhënë ju përkatësisht. Është gjithmonë rreziku që dëshmitari do të nxjerrë të dhëna identifikuese dhe këto rreziqe ekzistojnë pavarësisht se sa përpiqemi ne dhe me gjithë qëllimin e mirë që kemi. Pavarësisht sesa të kujdesshëm jemi kur bëjmë pyetje. Disa nga problematikat e tjera janë efikasiteti dhe cilësia e dëshmisë. Dhe kjo nënkupton edhe përdorimin e kodeve,

strukturimin e pyetjeve dhe kjo ndikon në cilësinë e përgjigjes. Pra, të dëshmisë që jep dëshmitari dhe detyrohemi pastaj t'i kërkojmë të përsërisë dëshminë. Ose detyrohemi t'i përsërisim pyetjet që të marrim aspektet që kemi dashur të dëgjojmë fillimisht.

Gjithashtu, ZPS-ja kuptohet që do të përpiqet që të respektojë sa më shumë urdhrin "Për zhvillimin e gjykimit" dhe do të marrë sigurisht parasysh udhëzimet tuaja sa i takon pyetjeve që bëjmë ne dhe të përpiqemi që të jemi sa më shumë në seanca publike.

Ne do të përpiqemi, ne propozojmë të përdorim kodet me disa dëshmitarë, por grupimi i pyetjeve ndonjëherë është në varësi të dëshmitarëve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Arsyeja pse i kemi dhe këtë vonesën në përcjelljen e seancave është pikërisht kjo, që në qoftë se dikujt i shket goja gjatë një seance publike dhe thotë diçka që nuk duhet ta kishin thënë, a thotë një emër a një vend, ne kemi mundësi ta redaktojmë, e heqim. Dhe kjo e eliminon një nga rreziqet. Por nuk e kuptoj pse qenka e vështirë atëherë.

Z. QUICK: [Përkthim] Sigurisht, kjo është një masë që i trajton disa nga rreziqet, por ama jo të gjitha rreziqet, sepse ka persona në galerinë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrallëherë,

rralllëherë.

Z. QUICK: [Përkthim] Jo shpesh, por ndodh. Por nuk e eliminon tërësisht rreziqet. Është bërë edhe një propozim nga ekipet e përbashkëta nga ekipet e Mbrojtjes që do vonohet, shtyhet transmetimi publik edhe me një a dy orë të tjera, sepse kjo u jep mundësinë palëve dhe Trupit Gjykues të shohin redaktimet që kanë bërë gjatë kësaj kohe dhe kërkesat për redaktim dhe t'i japin mundësinë publikut që të marrë sa më shumë informacion.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, ju nuk jeni kundër që ta shtymë edhe më tej transmetimin?

Ralph, atëherë Ralph nga Zyra Administrative. Në qoftë se keni ndjesinë që do të duhet të diskutohet diçka sa i takon këtyre pikave, ju lutem, mos hezitoni që të ndërhyni në çdo moment.

Z. ROCHE: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit, Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ekipet e Mbrojtjes? Nuk e di në qoftë se keni ndonjë koment të lidhur me këtë temë të parë që po diskutojmë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Këto çështje të vogla, me thënë të drejtën, unë i shikoj si çështje të mëdhaja.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për grupimin e pyetjeve, edhe gjërat të cilat po ndërhyjnë në mënyrë që të bëj një punë më të mirë. Edhe për shembull, si sot, nuk është se dua të vë gishtin te ti, por thuajse e gjithë kundërpyetjet

tuaja ishin seancë private, në seancë të mbyllur. Kështu që, pyetja ime teorike është që, a mund ta kishe organizuar paksa ndryshe mënyrën se si e merrnit në pyetje dëshmitarin, në mënyrë të tillë që një pjesë e kundërpyetjeve të mund të ishte në seancë publike.

Z. KEHOE: [Përkthim] Me thënë të drejtën, i nderuar Gjykatës, një pjesë e mirë e informacionit nuk është se ka të bëjë personalisht nuk ka lidhje, personalisht me këtë dëshmitar. Por ka të bëjë me çështje më të mëdhaja. Për shembull, në qoftë se bëhej fjalë për një dëshmitar të ndryshëm, në qoftë se do bëhej fjalë për një vend, për një dëshmitar që do ishte në vendin e dëshmitarin që kishim sot, ndoshta do kishte qenë më e mundur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rastin e dëshmitarit në fjalë e kuptoj, sepse ishte një vend tjetër.

Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon kodeve do ta them, se e përmenda në fakt edhe të hënën, e thashë edhe një herë tjetër, në javën e mëparshme, që kodet janë të vështira që të ndiqen nga klientët. Pa diskutim që janë të vështira edhe për ata që e ndjekin nga larg, le të themi, procesin këtu. Kështu që ka vështirësi të padiskutueshme lidhur me përdorimin e kodeve.

Megjithatë, kam një problem më të madh që ka të bëjë me dëshmitarët e mbrojtur. E kuptoj nevojën e tyre për t’u mbrojtur, për të pasur masa mbrojtëse, por po flasim për një numër të konsiderueshëm të këtyre njerëzve. Kështu që, pyetja

që duhet të ngrihet në rastin e tyre është që a nuk duhet të rishikohet edhe një herë statusi i të gjithë këtyre dëshmitarëve të mbrojtur për të parë në qoftë se është e nevojshme për të pasur këtë status apo jo?

Për shembull, në qoftë se një dëshmitar nuk jeton më në Kosovë, a nuk do ishte me vend që të rishqyrtohet edhe një herë në qoftë se ka nevojë apo për mbrojtje personale ky person? Sepse me thënë të drejtën, nga përvoja vetjake e di që shumë nga dëshmitarët që kanë masa mbrojtëse nuk kanë kërkuar fare masa mbrojtëse dhe ndërkohë janë dhënë këto masa pa i kërkuar fare asnjë opinion atyre. Kështu që, do sugjeroja që të rishikohen edhe një herë të gjitha masat mbrojtëse edhe të shohim se çfarë mund se cilët mund të jenë ata dëshmitarë që mund të hiqen nga ky ekuacion.

Për shembull, di një dëshmitar, nuk do t'ia them emrin, se jemi në seancë të hapur, dhe flasim për një dëshmitar i cili ka folur publikisht dhe pavarësisht kësaj është me masa mbrojtëse.

Kështu që, mendoj se në qoftë se do shkurtojmë numrin e dëshmitarëve me masa mbrojtëse kjo në vetvete do të çonte pa diskutim në shkurtimin e seancave të mbyllura. Sepse ne të gjithë jemi të interesuar që të kemi sa më shumë seanca të hapura që të jetë e mundur.

Nuk është qëllimi këtu që të diskutojmë vetëm thjesht provat e Prokurorisë, ndërkohë që është e rëndësishme edhe për Prokurorinë, jo vetëm për neve, në mënyrë që të kemi seanca të

hapura.

Kështu që, me fjalë të tjera, më lejoni të them që kur shohim numrin e konsiderueshëm të dëshmitarëve të cilët kanë masa mbrojtëse, kjo është shqetësuese. Jemi të hapur për idenë e kodeve, gjërave të tilla. Megjithatë, ky është qëndrimi ynë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, po sugjeroni që duhet të ketë një mënyrë për të rishikuar edhe një herë dëshmitarët për të parë në qoftë se ata janë akoma, i përmbushin masat, domethënë në mënyrë të tillë, ose kriteret në mënyrë të tillë që të jenë dëshmitarë të mbrojtur.

Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatës, unë vërtet, e kam seriozisht këtë, nuk është thjesht se e kam si prezumim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk duhet të prezumojmë asnjë gjë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Po mundohem -- të them të vërtetën, jo të tregohem i zgjuar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Megjithatë, le të pyesim Prokurorinë.

Z. QUICK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pra, ne aktualisht kërkojmë, pra, shikojmë urdhrin "Për zhvillimin e procesit gjyqësor" për kontaktimin e dëshmitarëve në mënyrë të mjaftueshme paraprakisht në mënyrë të tillë që ata të vijnë dhe të japin konfirmimin e tyre dhe të vijnë të japin dëshminë këtu. ZPS-ja gjithashtu respekton urdhrin "Për zhvillimin e procedurave".

Ka edhe një zbatim tjetër që kërkon ZPS-në, ka një kërkesë tjetër, një aplikim tjetër që i kërkon ZPS-së që të informojë Turpin Gjykues sa i takon kritereve që nuk vazhdojnë të jenë më të vërtetë për zbatimin e masave mbrojtëse.

Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo nuk është e saktë. Nuk po them që po gënjen, por po them që nuk është e interesuar ose nuk e di se çfarë po u ndodh dëshmitarëve.

Pra, përpara sesa të vinte protokolli ne po bënim hetimet tona dhe ndërkohë kemi hasur njerëz që nuk e dinin fare që ishin dëshmitarë. Dhe aq më pak që të kishin kërkuar masa mbrojtëse për ta. Pra, ne nuk e sajuam këtë gjë. Këtë informacion na e kanë dhënë dëshmitarët, e kanë thënë personat me të cilët kemi folur. Nuk po them që ka qëllime të këqija Prokuroria. Prokuroria në vetvete mund të ketë qëllime më të mira të mundshme. Megjithatë, situata në terren është kjo që sapo ju thashë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. EMMERSON: [Përkthim] Mbase deri në njëfarë mënyre do të përsëris atë çfarë ka thënë më përpara dhe z. Kehoe. Megjithatë, do ta them me fjalët e mia.

Është fakti që jemi përpjekur që të bëhet grupimi i pyetjeve, të bëhet grupimi i pyetjes së bashku, në mënyrë të tillë që të lehtësohet deri në njëfarë mase, pasojat e dëshmive të cilat mbahen ose të cilat zhvillohen në seanca të mbyllura.

Megjithatë, ka dy vështirësi shkak-pasojë për shkak të saj. Së pari, pra, në mënyrë që të respektohen masat edhe njëra gjë që ne mundohemi gjatë gjithë kohës ta kemi parasysh është që më mirë të jemi të kujdesshëm, sesa të dalë diçka që nuk duhet të dalë.

Së dyti, ka një pashmangshmëri për papërshtatshmërinë e këtyre masave dhe këtu lidhet me atë çfarë tha z. Kehoe. Le ta shohim në këtë mënyrë: duke marrë parasysh numrin e dëshmitarëve që kemi dëgjuar deri tani, ata kanë dhënë dëshmi në publik, në gjykatë me emrin e tyre në procese gjyqësore të brendshme, pra, në Kosovë. Dhe pavarësisht kësaj për këtë arsye Prokuroria i kërkon Trupit Gjykues edhe i thotë, në qoftë se e japin këtë dëshmi këtu edhe në qoftë se kjo jepet në seancë të hapur, atëherë ata do identifikohen dhe si rezultat, në qoftë se nuk kanë masat mbrojtëse nuk mund të bëhet publike thelbi i çështjes.

Atëherë, është e vështirë që të dihet si mund të gjejmë një zgjidhje të tillë nëpërmjet kësaj forme. Për shembull, një prej pyetjeve 4C bën pyetjen profetike e se si mund të shpjegojë, për shembull, Trupi Gjykues faktet apo duke marrë parasysh provat e dhëna përpara këtu në Gjykatë, ndërkohë që të dhënat apo parashtrimet e tyre nuk janë të dëgjueshme për publikun.

Pra, sigurisht mund ta shikojmë këtë edhe nga këndvështrimi i të drejtave të të akuzuarve për procese

gjyqësore të drejta ose të drejtën e publikut për t'u informuar se çfarë po bëhet nga autoritetet gjyqësore. Dhe duke pranuar në raste përjashtimore që mund të jetë e nevojshme, domethënë mund të jetë absolutisht e nevojshme që të bëhet përjashtim dhe që të bëhen seanca private.

Megjithatë, në situata në të cilat janë prezantuar gradualisht në këtë procedurë kur dikush për shembull ka dhënë prova ose dëshmi të më përparshme në gjykatë dhe kjo përdoret si bazë për të kërkuar masa mbrojtëse për të nuk dua që të bëj asnjë lloj deklarate, hiperbolike, por e vërteta është, domethënë, që qëllimi, pra, zhbëhet qëllimi kryesor i realizimit të seancave publike. Kështu që për këtë arsye, në qoftë se mbahen provat nga publiku, në qoftë se jepen, domethënë fabula ose zhvillime siç kanë ndodhur në qoftë se nuk i bëhen me dije publikut, nuk e kam, pra, në përjashtim të rasteve kur gjërat të cilat janë diskutuar më përpara në procese gjyqësore. Atëherë, edhe një herë ne i kemi lejuar këtij procesi gjyqësor, nuk është përgjegjësia e askujt, pra, gjithsesi, ne e kemi lejuar të gjithë neve së bashku, e kemi lejuar këtë proces gjyqësor që të mbërrijë në një zallamahi ose në një rrëmujë të vërtetë. Dhe ndërkohë, këto janë çështje të cilat kanë qenë të vërteta edhe në tribunale të tjera. Për shembull që mund të kenë qenë gjykatat e Kosovës, TPNJ-ja, gjykatat serbe dhe këto janë tipare e të cilat janë dalluese për të gjitha tribunalet apo gjykatat që janë marrë me krime

lufte.

Megjithatë, pavarësisht kësaj, nuk është, nuk ka pasur asnjë kërkesë sa i takon rrezikut të identifikueshëm ose rrezikut konkret ndaj dëshmitarit. Ndërsa kjo është marrë si e mirëqenë lidhur me këto procese mbi bazën e deklaratave të përgjithshme që kanë të bëjnë me kërcënimet e dëshmitarëve në Kosovë. Por përderisa ne kemi shembuj të manifestuar që dëshmitarët kanë dalë publikisht vetë dhe i kanë dhënë pozicionet e tyre dhe atëherë këto kërcënime nuk janë materializuar asnjëherë. Në fakt nuk ka pasur kërcënime dhe nuk ka kërcënime kundër dëshmitarëve. Dhe kur i pyet dëshmitarët, në qoftë se, e ti i pyet ata që a do të japësh dëshmi në seancë private dhe ideja është domethënë, ajo çfarë duhet të diskutojmë këtu është në qoftë se dëshmitarët duan që të dalin publikisht për të thënë dëshminë e tyre apo jo.

Por nuk duhet që kjo të jetë rregull i përgjithshëm. Por sepse parimi i përgjithshëm ose parimi bazë duhet të jetë që dikush në qoftë se dëshirën që të vijë të japë dëshmi duhet që të japë dëshmi duke u ekspozuar, pra, ne jemi nga ana tjetër e teleskopit; jemi nga ana tjetër e medaljes.

Megjithatë, siç e thashë, nuk është se duhet të hedh fajin mbi dikë, por ajo çfarë dua t'ju them dhe ju drejtohem me një pyetje këtu se si të shkruajë një aktgjykim në fund fare mbështetur në proces gjyqësor që është pothuajse i tëri në seancë të mbyllur. Dhe jemi tërësisht në pozicion të kundërt në

këtë pozicion që duhet të kishim qenë.

Tani në përmbledhje, i gjithë regjimi për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk duhet thjesht që të bëhet një pyetje dëshmitarëve përpara se sa të vijnë këtu, në qoftë se dëshironi të bëhet e hapur jo. Nuk është fare me rëndësi kjo gjë. Por çështja ose pyetja që duhet që të ngrihet është a është absolutisht e nevojshme që të zbatohen masa mbrojtëse dhe në fakt ky është thelbi i konventës. Seancat publike dhe të drejta përbëjnë, janë e drejta themelore e të akuzuarit. Dhe përjashtimi duhet të jetë vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme që të aplikohen masa mbrojtëse për dëshmitarët. Pra, është e rëndësishme që masat mbrojtëse të jepen në mënyrë proporcionale me rrezikun e individit që supozohet që të jetë i rrezikuar.

Pavarësisht nga përmirësimi që mund të bëjmë unë mendoj që absolutisht duhet që të diskutojmë me Trupin Gjykues të drejtën për proces të drejtë ligjor dhe seanca publike. Dhe ky do jetë pozicioni jonë në apel në çdo fazë në qoftë se kjo do të jetë e nevojshme.

Ne sugjerojmë që të rimendohet tërësisht në mënyrë ndryshe gjithë procesi. Pra, të vlerësohet edhe një herë pozicioni i dëshmitarëve dhe të mendohet dhe që të identifikohet, të identifikohen vetëm ata persona të cilët kanë nevojë të masave mbrojtëse. Pra, të bëhet një analizë e vërtetë e dëshmitarëve. Domethënë, kjo analizë e vërtetë nuk është bërë asnjëherë.

Domethënë përgjithësisht është Gjykatësi i Procedurës Paraprake i cili ka vendosur; ai ka marrë vendimin e vet paraprak, por nuk është bërë absolutisht asnjëherë një vlerësim duke u mbështetur në kriteret ose parashtrimet specifike për të gjithë dëshmitarët për të cilët është kërkuar masa mbrojtëse. Kështu që një vendim ligjor nga Trupi Gjykues lidhur me atë çfarë kërkohet që të justifikohet një, pra, drejtim tjetër ose le të themi përjashtimi, që është seancat e mbyllura. Pra, është i nevojshëm që të bëhet, mbështetur në kritere specifike që duhet të parashtrohen nga Prokuroria. Megjithatë, siç janë zhvilluar ngjarjet, situata është e tillë që situata nuk mund të ndreqet ndryshe përveçse në qoftë se do të duhet që të rimendohet tërësisht ndryshe, në mënyrë radikale tërësisht ndryshe.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

Nuk është një pyetje për ju z. Emmerson, por frymëzohet prej jush kjo pyetje.

Z. Quick, jam pjesërisht dakord apo pajtohem pjesërisht me shqetësimin e z. Emmerson lidhur me atë çfarë ai e identifikoi në mënyrë të saktë si diçka që parashikohet në pikën 4(c), që ka të bëjë me natyrën publike të procesit gjyqësor. Në një fazë të caktuar do të na duhet që të japim, të shkruajmë aktgjykimin që do të bëhet publik dhe duhet të jetë gjithëpërfshirës. Kështu që, një prej shqetësimeve që kam unë është një shqetësim

i cili veçanërisht lidhet me mënyrën se si juve zbatoni ose paraqisni qasjen tuaj që ka lidhur me redaktimet.

Do ju bëj një pyetje, do ju jap gjithashtu edhe një shpjegim që mbase mund t'ju ndihmojë për t'i dhënë përgjigje pyetjes që do t'ju bëj. Pyetja ime është kjo: Si e imagjinoni që Trupi Gjykues të jetë në gjendje të shkruajë një aktgjykim të kuptueshëm, gjithëpërfshirës, publik në qoftë se do të ndjekim mënyrën sesi interpretoni ju detyrimet për redaktime siç u theksua nga z. Emmerson. Pra, për çdo fakt i cili mund të çojë në identifikimin e një personi tjetër i cili fakt në vetvete mund të çojë në identifikimin e një kushëriri apo që mund të identifikojë dëshmitarin që ju me të cilin juve, pra, arsyetoni redaktime tuaja.

Për shembull, si ilustrim, ky Trup Gjykues ka marrë parasysh, ka marrë njoftim gjyqësor të disa fakteve të gjykuara të cilat janë gjykuar në mënyrë publike. Dhe që besoj do të përbëjë një lloj baze ose themeli për çështjen edhe që ju më pas do të jepni prova që keni marrë nga dëshmitarë, përfshirë këtu edhe dëshmitarët e mbrojtur.

Pyetja që kam unë për ju është kjo: Si ka mundësi që të bëjmë konstatime ne lidhur me këto incidente në qoftë se lidhja që bëhet ndërmjet incidentit në fjalë dhe dëshmitarit X është e redaktuar? Çfarë do të bëjmë, do të shkruajmë një aktgjykim të themi që në këtë datë të redaktuar, në këtë vend të redaktuar, viktima e redaktuar është vrarë nga autori ose kryesi i

redaktuar, në këtë vend të redaktuar? Domethënë, si pretendoni juve që të shkruajmë ne aktgjykimin, domethënë si është e mundur që të Trupi Gjykues të mund të shkruaj një aktgjykim gjithëpërfshirës publik duke ndjekur të gjithën logjikë të redaktimeve që aplikoni ju?

Kështu që, me fjalë të tjera, nuk e di në qoftë se mund të na ndihmoni se çfarë duhet të bëjmë, se si duhet të veprojmë në këtë aspekt.

Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.

Së pari, shkurtimisht, në përgjigje të asaj çfarë u tha nga Mbrojtja, ZPS-ja dhe Trupi Gjykues dhe Gjykatësi i Procedurës Paraprake kanë respektuar kërkesat për publicitet të gjykimeve dhe masat mbrojtëse janë urdhëruar në mënyrë individuale të justifikuara sipas kritereve për personat përkatës. Dua ta bëj të qartë për procesverbal këtë gjë.

Sa i takon Konferencës për Ecurinë e Procesit, edhe sa i takon masave të veçanta që mund të ndihmojnë Trupin Gjykues në veçanti në kuadrin e masave mbrojtëse, të cilat janë domosdoshmërish strikte.

Lidhur me publicitetin e gjykimit, mjeti më efektiv i arritjes së kësaj gjeje është redaktimi dhe rishikimi pas listimit ose renditjes së provave dhe të dhënave në seanca të mbyllura. Do të merrja për shembull, e marr parasysh shembullin që thatë, i nderuar Gjykatës, e kuptoj atë çfarë doni të thoni, nuk është se është një ndodhi e parregullt në gjykata të tjera,

sa i takon aktgjykimeve përfundimtare që Trupi Gjykues i merr parasysh, provohet në tërësinë e tyre dhe bëhet riklasifikimi i pjesëve shtesë të informacionit në mënyrë që të referohemi ndaj seancave private dhe seancave të mbyllura.

Sa i takon fakteve të gjykuara, sa i takon atyre dëshmitarëve që lidhen me fakte të gjykuara, të cilat mund të identifikohen ose jo dhe lidhjen ndërmjet tyre, më lejoni të them që kjo është diçka e cila ka të bëjë konkretisht me individët, me dëshmitarët dhe do të duhet që të shqyrtohet rast pas rasti, se cilat janë rrethanat e secilit prej tyre.

Z. METTRAUX: [Përkthim] Nuk dua t'ju vë t'ju drejtoj gishtin apo t'ju vë në pozitë të vështirë, z. Quick. Megjithatë, thashë që ky ishte një shembull ilustrues i një problemi shumë herë më i madh sesa kaq.

Një tjetër shembull, që e përmendi z. Emmerson në mënyrë kalimtare është që ju keni dëshmitarë të cilët raportojnë një dëshmitari i cili është në masa mbrojtëse. Dhe pastaj, sipas qasjes tuaj, është e vështirë që të gjenden ose të bëhen konstatime publike në lidhje me incidentin në fjalë për arsye të cilat i keni ndjekur që prej fillimit të këtij procesit në kuptimin që një fakt mund të çojë në zbulimin e një fakti tjetër, në zbulimin e një dëshmitari tjetër e kështu me radhë. Dhe në qoftë se ne do të ndiqnim qasjen tuaj, atëherë i takon që ky Trup Gjykues do të detyrohej që të shkruante një vendim jopublik ose shumë jopublik.

Siç e thashë, nuk dua t’ju vendos në vend, në një pozitë të vështirë, por thjesht dua që ta shqyrtoni edhe një herë këtë çështje, sepse është një çështje shqetësuese për neve në këtë pikë të procesit gjyqësor.

Z. QUICK: [Përkthim] E kuptoj, të nderuar Gjykatës. Pa diskutim që do ta marrim parasysh dhe në të ardhmen gjatë zbatimit të redaktimeve të tjera. Do ta marrim parasysh këtë kërkesë tuajën.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë pas dëshmisë së këtij dëshmitari, propozoni që t’i hiqni këto redaktime?

Z. QUICK: [Përkthim] Parashtrimet tona, të nderuar Gjykatës, ne i kemi thënë që kjo do të jetë jo më vonë se dhjetë ditë pas paraqitjes së transkriptit. Pra, është periudha kur ZPS-ja do të paraqesë propozimet e saj për heqjen e këtyre redaktimeve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëhet fjalë për heqjen e një numri të madh syresh? Pra, të thuash që do të heqim disa prej redaktimeve nuk mjafton. Shumica e këtij materiali, siç ju kemi thënë më përpara, sipas nesh është e konservaton qasjen dhe po përpiqem që t’i zgjedh fjalët mirë. Por nuk duhet të jetë kështu. Nuk duhet të jetë qasje konservative e pazakontë e kësaj natyre.

Duam që të kemi disa shembuj. Duhet të na tregoni disa shembuj me të cilët të ilustroni që këto janë rastet ku mund të

hiqen redaktimet.

Z. QUICK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo është një ide shumë e mirë. Kemi paraqitur disa parashtrime të tilla. Është, ne kemi paraqitur, për shembull për më duket se ka përfunduar sot dosja lidhur me dëshmitarin 0103165 [sipas përkthimit]. Dhe ne do të ndjekim të nderuar Gjykatës, sugjerimin që bëni ju në periudhën në vazhdim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, faleminderit z. Emmerson dhe z. Kehoe për prezantimin tuaj.

Z. Emmerson, deshët të ngrinit diçka të ndryshme? Përpara jush, z. Kehoe.

Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. EMMERSON: [Përkthim] Disa hollësi. Për sa i përket Dëshmitarit 3165, kronologjia është e tillë. Me 23 maj ka përfunduar dëshminë dëshmitari. Më 1 qershor ZPS-ja ka paraqitur kërkesën për riklasifikim. 14 qershor është përgjigjur Mbrojtja. 20 qershor Prokuroria është kundërpërgjigjur dhe ka kaluar një muaj, deri më tani, për të arritur në pikën që parashtron, që paraqet pikërisht shqetësimin tuaj.

Dhe tani që jam ngritur më leni të përmend diçka tjetër. Unë po e paraqes këtë për rend të ditës tani që po i shqyrtojmë. Të dy këto faktorë tregojmë se sa nga dëshmitë duhet dëgjuar në seancë të mbyllur, pasi të dy këto kanë të bëjnë me dëshmitarë për të cilët, për të cilët do të vazhdojnë

të ketë seanca të mbyllura. Por ka lidhur edhe me çështje që keni ngritur ju, të nderuar Gjykatës, gjatë ditës së djeshme, për sa i përket përshpejtimit të procesit në përgjithësi.

Gjykatësi Mettraux përmendi përpara ca kohësh se disa nga dëshmitarët i ka thirrur Prokuroria për të dhënë dëshmi lidhur me ngjarje për të cilët ka patur raste, raste gjyqësore të pranuara nga kjo Gjykatës. Dhe kjo mbi bazën e dëshmive që ata dhe dëshmitarët e tjerët kanë dhënë në procese të ndryshme penale në Kosovë.

Kur ndodh një gjë e tillë, sipas nesh, do të ishte e përshtatshme që Trupi Gjykues t’i tregonte Prokurorisë se nga ky moment e tutje ato duhet ta analizojnë dëshmitarin i cili jep dëshmi lidhur me fakte gjyqësore të shqyrtuara më parë për të parë nëse dëshmia e tyre provuese. Është shtesë ndaj fakteve të shqyrtuara gjyqësore të shqyrtuara më parë që i keni marrë parasysh ju të nderuar Gjykatës. Dhe dëshmitari i parafundit ishte shembull i mirë ilustrues, pasi vlera e vet provuese që është nxjerrë përmes atij ishte lidhur me faktet e shqyrtuara, gjyqësore të shqyrtuara më parë. Pra, mund të ngrihet pikëpyetja, ishte e domosdoshme të thirrje ky dëshmitar? Ndoshta ka një element pjesëmarrës si viktimë që është një proces i cili e ngadalëson gjyqin, megjithëkëtë, do të ngrija një pikëpyetje: Çfarë përbën Prokuroria kur thërret një dëshmitar i cili merret në pyetje për të përcaktuar një fakt i cili është shqyrtuar më parë dhe pranuar nga Trupi Gjykues për

të cilët ju mund ta paraqisni në aktgjykimin tuaj pa problem. Një tjetër çështje është dëshmia e rregullës 154. Disa nga pyetjet tuaja kanë të bëjnë me përgatitjen e një përmbledhjeje pas dëshmisë ku të përmblidhet pa shkelur masat mbrojtëse çfarë ka thënë dëshmitari në seancën e mbyllur dhe kjo të publikohet. Por ka edhe një mënyrë tjetër për ta parë këtë. Në tribunalet e tjera e zbatojnë këtë që në rastet kur dëshmitari jep dëshmi të 154-s, pra, me shkrim, Prokuroria përgatiti një përmbledhje paraprakisht duke thënë që këtë presim të thotë ky dëshmitar dhe këtë ka materiali i rregullës 154. Pra, një përmbledhje të shkurtër të asaj që do të thuhet. Dhe në atë moment ato kalojnë drejtpërsëdrejti në pyetjet nga pala kundërshtare.

Nuk ka nevojë që të bëjë pyetje Prokuroria siç ndodhi me dëshmitarin e fundit. Pra, dëshmia gojore të gjerësishme e cila në fakt është njësoj si dëshmia 154 që në fakt bën të domosdoshëm kalimin në seancën private. Dhe unë do të sugjeroja që seancat private janë pikërisht për shkak se është duruar dhe është [e pakuptueshme] Prokuroria që t'i bëjë argumentet në mënyrën si po i bën.

Z. KEHOE: [Përkthim] Ky koncept i rishikimit të redaktimeve pas faktit e ndërlikon të tërë procesin penal. Unë e kuptoj synimin dhe qëllimin e tij, por është e vështirë për të përgatitur për dëshmitarët pa patur parasysh faktin që duhet të shikojmë se çfarë mendon ZPS-ja lidhur me redaktimet të cilat duhen hequr apo jo. Ky është një proces që zgjat, ha

shumë kohë. Sido që të shikohet.

Tani çështja tjetër. Çështja që ka të bëjë me dëshmitarët. Dhe këtë e ngriti Gjykatësi Mettraux kur përmendi çështjen e aktgjykimit. Si mund të ngrihet të nxirret një aktgjykim me këto redaktime, çfarë bëjmë atëherë me këta dëshmitarë, dëshmia e të cilëve, të cilët e kanë dhënë dëshminë dhe më pas publikisht tregojnë se ç’kanë thënë. Dhe kjo ndërlidhjet drejtpërsëdrejti me atë që tha Gjykatësi Mettraux. Është një palë e tretë atje dhe në seancë të mbyllur mund të japë emrin po të dëshironi, që e ka bërë këtë gjë. Që ka dalë dhe tregon të gjithë rrëfimin dhe nuk është vështirë që të bëhet ndërlidhja mes tij dhe aktgjykimit që mund të nxjerrë ky Trup Gjykues. Dhe ky është fakt që ka ndodhur kohët e fundit.

Kur faktet që i kanë ndodhur këtij personi i ka nxjerrë në publik vetë ky person, atëherë cili është detyrimi që ka kjo Gjykatë për të mbajtur masat mbrojtëse ndaj tij? Është një problem konkret, shumë i vështirë dhe nëse dëshironi t’i dëgjoni emrin, të nderuar Gjykatës, do ta bëja me shumë kënaqësi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Kehoe nuk po ju shmang, por ju më detyroni që të bëj një pyetje tjetër që kisha për ZPS-në. Dhe pyetja është kjo:

Siç e paraqitët dhe me të drejtë të gjitha vendimet për

masat mbrojtëse janë marrë pasi janë analizuar treguesit se këto masa janë të domosdoshme. Dhe janë bërë në bazë duke zbatuar një standard të duhur ligjor. Të jemi të qartë për këtë.

Sidoqoftë, pyetja që kam unë është që se mund të ketë justifikime të masave mbrojtëse përpara dhënies së dëshmisë së një dëshmitari për të mbrojtur këtë individ nga trysnia, frikësimi, kërcënimi dhe ambienti i përgjithshëm i frikësimit të dëshmitarëve që ne e dimë që ekziston. Por pyetja është nëse masat mbrojtëse do të vazhdojnë të jenë dhe të mbahen në të njëjtin nivel pasi të ketë dhënë dëshminë dëshmitari me fjalë.

Dhe kjo ndërlidhet me atë që ju përmendët rastësisht, ju duke përmendur, duke përmendur rregullën, paragrafin 67 të urdhrit mbi çështje penale. Dhe pyetja që kam unë është se cilat janë masat që ju po ndërmerrni për të vërtetuar nëse nevoja që mund të kishte ekzistuar deri në momentin e dhënies së dëshmisë së një dëshmitari do të duhet të mbahen edhe pas dhënies së kësaj dëshmie. Dhe arsyeja është, pse e bëj këtë pyetje, është e qartë, pasi mund ta zgjidhim këtë çështjen që ngrita pak më herët, çështjen, pra, të të shkruarit të një aktgjykimi i cili duhet të jetë publik.

Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

ZPS-ja, siç e thashë më parë, analizon domosdoshmërinë e masave mbrojtëse dhe i kontakton dëshmitarët edhe pasi kanë dhënë dëshminë e tyre për të diskutuar shqetësimet që mund të

kemi mbi çështjet e sigurisë dhe çështjet e tjera. Ka ndoshta disa raste të kufizuara kur këto masa mund të mos jenë të domosdoshme pas dhënies së dëshmisë së këtij dëshmitari kur kanë ndryshuar rrethanat të cilat të ndikojmë mbi këtë.

Sidoqoftë, shumë prej të cilave raste këto masa mbrojtëse vazhdojnë të jenë të domosdoshme edhe pas dhënies së dëshmisë së një dëshmitari dhe kjo është e parashikuar nga rregullorja. Por kjo është edhe pjesë e vendimeve të marrë për masat mbrojtëse në shumë raste që ka të bëjë me rrezikun që paraqet dëshmia e dëshmitarit por edhe rreziku që ka thjesht bashkëpunimi i dëshmitarit me ZPS-në apo fakti që kanë dhënë, fakti i përgjithshëm që kanë dhënë dëshmi para ZPS-së. Dhe në këtë kontekst, fakti që dëshmitari ka dhënë dëshmi mbahet parasysh në procesin e analizimit të domosdoshmërisë së masave mbrojtëse. Por nuk është faktori vendimtar. Siguria e dëshmitarëve nuk përfundon në momentin e dhënies së dëshmive. Në fakt në disa raste ky rrezik rritet më tej. Ndërhyrja mund të ndodh në çdo çast edhe në fazat e tjera të procesit gjyqësor.

Kjo ka ndodhur edhe në apel edhe pas përfundimit të procedurave gjyqësore në tërësi. Kështu që nevoja e mbajtjes së masave mbrojtëse nuk është në varësi thjesht të përfundimit të dëshmisë së një dëshmitari dhe ZPS-ja i përmbahet detyrimit për t’i analizuar masat mbrojtëse edhe në bazë të fakteve të pranuara më parë të ndryshimit të rrethanave.

Megjithëkëtë, informacion duhet të mbetet që është dhënë në seanca private dhe [e pakuptueshme] konfidencial, pasi kjo bën të mundur mosidentifikimin e dëshmitarit. Pra, kur bëhet vlerësimi i dëshmisë atëherë ZPS-ja si pala thirrëse do të jetë në gjendje të tregojë që disa pjesë do të duhen të bëhen publike. Dhe një fazë tjetër është në përfundim të procesit penal kur Trupi Gjykues ka parë në tërësi të gjitha këto dëshmi dhe atëherë mund të vendosë se cilat pjesë të informacionit do të jenë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni patur ndonjë rast të një dëshmitari i cili ka dhënë dëshminë dhe e di që vetëm kemi tre muaj që dëgjojmë çështjen këtu në sallën e gjyqit. Po a keni dëgjuar ndonjë rast të një dëshmitari i cili të ketë pësuar kanosje pas dhënies së dëshmisë?

Z. QUICK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, për sa i përket kanosjes --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarëdolloj.

Z. QUICK: [Përkthim] Që është frikësuar --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çdo rast.

Z. QUICK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jo, nuk jam, nuk mund të tregoj këtu çështje individuale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pyes a keni ndonjë rast?

Z. QUICK: [Përkthim] Jo i nderuar Gjykatës, nuk kemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk kemi

dëgjuar ende nga z. dhe znj. në fund.

Z. TULLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kolegët e mi e kanë mbuluar në mënyrë të plotë të gjitha çështjet që deshëm të ngrinim. Edhe ne faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Nuk kemi gjë tjetër për të shtuar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. LAWS: [Përkthim] Po e filloj me këtë çështje. Ne të gjithë dëshirojmë të njëjtën gjë. Një gjyq që të jetë sa më i hapur që të jetë e mundur dhe publike me kusht që të ruhet, që të ruhen dëshmitarët dhe perceptimi që ata vetë kanë për sigurinë.

Arsyeja se përse po shtoj diçka është që ne nuk mund të përqendrohemi thjesht me të drejtën për një gjyq të hapur. Ne të gjithë e kuptojmë sesa e rëndësishme është një gjë e tillë. Ndërhyrja ndaj dëshmitarëve dhe viktimave vazhdon të ekzistojë.

Të premten në darkë, ekipi im biseduan me një person i cili sapo kishte marrë një kërcënim me vdekje lidhur me atë që besoj se ishte bashkëpunim me këtë Trup Gjykues dhe ne e kemi njoftuar në mënyrën e duhur. Kjo është thjesht për të nënvizuar që është një situatë që vazhdon të ekzistojë për njerëzit në Kosovë. Ishte një person i cili nuk ishte dëshmitar, por i cili

ishte perceptuar në mënyrë të gabuar se mund të ishte.

Megjithëkëtë, kjo ilustron pikërisht këtë çështje. Këta dëshmitarë vijnë nga një ambient ku ndihen të kanosur. Nëse kanë marrë kërcënime si ai që kam përshkruar unë apo jo ata ndiejnë, ndihen të kanosur dhe kur vijnë për të dhënë dëshmi këtu shumica e tyre besojnë po rrezikojnë veten dhe kanë zgjedhur ta bëjnë një gjë të tillë në mënyrë të përgjithshme për atë që ata mendojnë që është e mira e të tërëve.

Publiciteti, gjyqi publik është i rëndësishëm por nuk mund të jetë edhe mbizotëruesi. Pa bashkëpunimin e dëshmitarëve nuk mund të ekzistojë një gjyq i cili të mund të transmetohet publikisht fare. Dhe ne e kuptojmë se ka vështirësi teknike dhe procedurale për të siguruar që këto procedura të jenë sa më të qasshme. Megjithëkëtë, ne mendojmë që është e rëndësishme të nënvizojmë frikën që ende ekziston. Dhe ne dimë që Trupi Gjykues do t'i marrë parasysh këto në vendimin që do të arrijë eventualisht.

Përpara se të ulem, më lejoni të përmend edhe çështjen që përmendi z. Mettraux për periudhën pas dhënies së dëshmisë. Dhe mund të ketë raste kur ZPS-ja do ta bëjë këtë gjë dhe kjo vlen për personat të cilët unë i përfaqësoj, shumicën e njerëzve që përfaqësoj unë. Sidoqoftë, dhe ne e kemi parë që ku jetojnë këta në komunitetin e tyre dhe në qoftë se ata shkojnë dhe kthehen në shtëpitë e tyre dhe merret vesh që ata janë paraqitur këtu, ajo do të jetë një situatë që do ta ndryshojë

tërësisht jetën e tyre. Nuk kam mënyrë tjetër për ta shprehur.

Ka shumë njerëz që e mbështesin këtë Gjykatë në Kosovë dhe besojnë që është një mjet për ndryshim, por ka edhe shumë të tjerë që nuk e besojnë një gjë të tillë. Dhe duhet të mbajnë parasysh për këtë arsye që shumica e njerëzve të cilët i keni parë këtu, vijnë nga ambiente, komunitete ku njihen gjerësisht nga njerëz të cilët mund t'ua ndryshojnë jetën, që mund t'ua ndryshojnë jetën në shumë mënyra. Që nga përjashtimi social dhe të vazhdojë më tutje dhe këta nuk janë faktorë të parëndësishëm.

Shumicës së këtyre njerëzie po u kërkojmë që të kryejnë këtë detyrë të rëndësishme të dhënies së dëshmisë, duke patur parasysh që jeta e tyre do të përkeqësohet dhe duke ditur këtë fakt ky nuk është stimul, por është e kundërta.

Këto ishin parashtrimet që desha të paraqisja unë. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, z. Laws.

Z. KEHOE: [Përkthim] Një koment. Neni 44 [sipas përkthimit] i jep përparësi të drejtës; neni 40 u jep përparësi të drejtës së të akuzuarve përkundrejt mbrojtjes. Sigurisht nuk duhet cenuar ky nen me këto masa mbrojtëse që përdor ZPS-ja. Nëse shohim çfarë ka ndodhur këtu deri tani dhe çfarë ka përparuar Prokuroria kapërcen së tepërmi masat mbrojtëse që janë zbatuar në tribunalët e tjetër ku kemi punuar për vitet të

rëra, sikurse është edhe TPNJ-ja. Asnjë tribunal nuk ka dhënë një masë mbrojtëse si këto që kemi parë këtu; si këto, pra, që ka kërkuar Prokuroria.

Dëshmitarët në gjithë botën shkojnë nëpër gjyqe. Ju keni në gjyqe, keni qenë në gjyqe siç kam qenë edhe unë gjithë jetën. Dëshmitarët gjithmonë ndihen të kërcënuar. Janë nervozë, kanë ndenja të ndryshme. Madje po mos t'i kishim të gjitha këto ndjenja do habitesha. Por kjo nuk do të thotë t'ju japësh menjëherë masa mbrojtëse. T'i fshehim pas perdeve, të kalojmë në seanca private që është pikërisht që po propozon Mbrojtësi i Viktimave. Nuk është ky rasti ynë dhe sa i takon mënyrës si do shkruhet aktgjykimi, si do shkruhet një aktgjykim me këtë informacion që kemi.

Nëse duam shembuj konkret me Prokurorinë, Prokuroria mund të bëjë diçka konkrete dhe unë kam edhe një dëshmitar që mund t'ua tregoj si të bëhet kjo. Sepse nëse faktet për të cilat dëshmon një person janë nën masa mbrojtëse për shkak të frikës atëherë s'është e vështirë të kuptosh se kush është dhe personi, ë, dhe ka ndodhur. Dhe ka qenë pikërisht një nga dëshmitarët e ZPS-së. Mos flas për dëshmitarët që nuk e dinë fare që janë dëshmitarë dhe ju janë dhënë masa mbrojtëse.

Shihni këtë dëshmitarin konkret. Hiqini masat mbrojtëse dhe nuk do kishim problemin për të cilin foli Gjykatësi Mettraux. Por të ndihesh i kërcënuar dhe të jetë kjo baza për dhënien e masave mbrojtëse është krejt e panevojshme. Nuk është

e saktë dhe cenon të drejtat e të akuzuarave.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

Z. Quick, më vjen keq që do merrem vetëm ty. I lexova me kujdesa parashtrimet e tua dhe vura re që aty ke thënë:

"Në këtë moment masat mbrojtëse nuk janë kërkuar dhe nuk janë marrë parasysh, nuk janë të konsideruar të nevojshme në përputhje, për më shumë se 150 dëshmitarët".

Dhe në një, poshtë shënimit e keni shpjeguar që nuk janë të gjithë dëshmitarë *viva voce*, por unë mendoj që shumica janë. A nuk është e rëndësishme duke pasur parasysh natyrën e këtij gjykimi? Atëherë, të bëj tre propozime:

A mendoni ju që ka një lidhje mes seancave publike dhe perceptimit nga komunitetet që preken që proceset të jenë të drejtë? A mendoni se duhet, sigurisht që duhet të gjithë të pajtohemi që këto seanca të jenë publike dhe në një gjykim me rëndësi kaq të madhe?

Kemi dhe përgjegjësi, ju si Prokurori, veçanërisht, të siguroni që seancat të jenë publike për komunitetet që janë të prekura --

Z. QUICK: [Përkthim] Pajtohemi me të gjitha parashtrimet që ju thatë. Ama do doja që të korrigjoja diçka. Duhet ta kisha sqaruar përgjigjen e pyetjes që i dhashë Kryegjykatësit më

herë. Kur thashë, me sa di unë, për personat që intimidohen pas faktit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]Unë e kuptova. Ju po bënit të pamundurën.

Z. QUICK: [Përkthim] Tani sa i përket pyetjes së Gjykatësit Gaynor të gjitha kanë aspekte dhe parime që sigurisht ka rëndësi për Prokurorinë dhe janë të rëndësishme për një gjykim të këtij lloji. Kuptohet që nuk po i ndjekin dot komunitetet që janë të prekura në një proces të tillë. Prokuroria e pranon që ka lidhje me seancat publike dhe perceptimit që kanë komunitetet e prekura që procesi duhet të jetë i drejtë. Nuk është, sigurisht nuk është e thënë që ka masa për dëshmitarët që japin dëshmi në seancë publike. Shumica e dëshmitarëve që dëshmojnë në seancë publike që mund të garantojnë një shkallë të madhe publiciteti sa i takon përmbushjeve të kritereve të publicitetit dhe përmbushjes së kërkesave të drejtësisë. Besoj se kur kemi bërë parashtrimin tonë të protokolluar, ne kemi përmendur disa raste apo jurisprudence të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe rrethanat e ndryshme që kanë pasur ata. Edhe rastet kur mund të përjashtohet publiku kur është veçanërisht e domosdoshme, dhe apo rreptësishtë e domosdoshme, madje edhe nga një gjykim i tërë. Por sigurisht, ne pajtohemi që dhe parimi i seancave publike duhet të kërkohet, duhet të zbatohet kur është veçanërisht e domosdoshme dhe proporcionale.

Sa i takon pyetjes suaj të aspektit tuaj të dytë, po, është e vërtetë. Ndikohet nga masat mbrojtëse edhe seancat që ne mbajnë në seanca të mbyllura. Dhe sikurse tha edhe Gjykatësi Mettraux kjo do të reflektohet në njëfarë mënyre në aktgjykimet e parashtrimet përkatëse. Më duhet të theksoj sërish, edhe sikur të jetë ky rasti, këto janë të gjitha objekt masash mbrojtëse që janë veçanërisht të domosdoshme sepse rrethanat i kërkojnë. Sikurse kemi një sërë dëshmitarësh për shkak të rrezikut apo ndërhyrjes apo intimidimit që u bëhet këtyre dëshmitarëve. Në këtë kuadër Prokuroria i ka argumentuar dhe Trupi Gjykues e ka shqyrtuar nevojën e zbatimit të masave mbrojtëse dhe ka pranuar që në këto raste duhet të bëhet një përjashtim nga parimi i seancave publike dhe të merren parasysh masat mbrojtëse.

Sikurse e thamë në parashtrimet tona ka disa, ka disa instrumente se si publiku mund ta ndjekë seancat, janë seancat paraprake, ka parashtrime të protokolluara në faqen e internetit. Ka pjesë të seancave, pra, publiku është në gjendje që t'i ndjekë një pjesë të tyre dhe të kuptojë se çfarë provash po paraqesin palët. Edhe të mund të ndjekin zhvillimet në procesin gjyqësor; le të shohin se si po funksionon procesi.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të them që sigurisht do të ishte më mirë disa të dëgjojmë më shumë nga domethënë të dëgjojmë shumicën e këtyre dëshmitarëve, të grupit prej 150 dëshmitarësh që keni paraqitur ju; t'i dëgjonim më shumë pa

masa mbrojtëse. A është nevoja të ketë masa mbrojtëse, sepse do të kishim një shkallë më të madhe të seancave publike.

Z. QUICK: [Përkthim] Një nga faktorët që është i rëndësishëm është edhe sigurisht lënda e dëshmisë së dëshmitarit. Kjo ndikon shumë pastaj masat mbrojtëse që kërkohen dhe ato që miratohen. Por Prokuroria patjetër do t'i marrë parasysh propozimin tuaj.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Për t'iu përgjigjur si z. Quick dhe z. Laws, do ta bëj shumë shkurtimisht.

Pikë së pari, z. Laws, si nga pikëpamja kontekstuale dhe parashtron apo krijon përshtypjen sikur po e ekuilibroni, po peshoni dy faktorë. Nga një anë keni këtë, dhe nga një anë keni interesat e komunitetit të dëshmitarëve nëse mund të përdor këtë lloj formulimi.

Nuk duhet të bëjmë këtë lloj ekuilibrimi këtu. Ne jemi në një situatë ku ligji kërkon një prezumim të fortë në favor të drejtësisë së hapur për arsye që nuk lidhen vetëm me të drejtat e të akuzuarve këtu, por edhe me të drejtat e publiku. Dhe çfarë mund të bëjmë ne për ta kapërcyer këtë. Të marrim parasysh, të gjejmë, të peshojmë të gjithë faktorët. Nuk është puna këtu të zgjedhim çfarë është më e volitshme apo çfarë është më e vështirë për dëshmitarët. Ata e kanë për detyrë, detyrë publike të marrin pjesë. Dhe kjo është diçka nga gjërat që duhet marrë në konsideratë.

Po, Prokuroria dhe të gjithë ne në fakt e dimë që duhet të

zbatojmë prezumimin e seancave të hapura. Masat mbrojtëse që kanë rezultuar në seanca të mbyllura deri më tani, pothuajse se çdo gjë në këtë çështje ka qenë e mbyllur. Këto janë miratuar mbi standardin se është e nevojshme të përjashtojmë çdo rrezik të mundshëm sado teorik të jetë ky rrezik.

Pra të eliminojmë ngjashmërinë dhe sikletin që mund të kenë dëshmitarët. Ky është standardi që është zbatuar. Këtë kam marrë parasysh Prokuroria; këtë parashtroi edhe z. Quick kur foli për rreziqet teorike, tha bile më përpara tha shiko tha se mund të ketë njerëz në galerinë publike kur kemi seanca të mbyllura.

Por, në fund të fundit, nuk bëhet fjalë për një ekuilibrim këtu. Duhet të kemi prezumimin. Duhet të kemi, t'i peshojmë siç duhet faktorët dhe nuk janë peshuar siç duhet deri tani. Asnjë nga këta dëshmitarë, nuk ka pasur ndonjë justifikim të përligjur. Dhe pa kalojmë dhe në një kemi kaluar në një gjykim sekret; 50% e dëshmitarëve janë të fshehtë. Pra, gjysma e listës së dëshmitarëve askush nuk mund të thotë tani që ne nuk po bëjmë një gjykim sekret. Në fund të fundit bëhet fjalë për cili është përkufizimi i fshehtësisë së një çështje. Pse po e privojmë publikun nga përcjellja e këtyre seancave publike.

Krahas konfidencialitetit, OK, e kuptojmë dhe interesin publik sikurse e tha edhe Gjykatësi Gaynor. Por është edhe një faktor tjetër që është shumë i rëndësishëm në proces, në një proces të tillë. Komuniteti, për llogari të kujt po bëhet ky

gjykim, të shoh edhe cilësinë e drejtësisë që po shërbehet këtu. Dhe ndonjëherë këtu vijnë dëshmitarë për Prokurorinë, sepse i shikojnë dëshmitë ose ndonjëherë del informacion i ri nga mbrojtja që mund të përdorë për të kundërshtuar Prokurorinë. Por nuk po zbatojmë standardin ligjor që duhet respektuar realisht në gjykimet e këtij lloji.

Dhe nëse shohim tamam një gjykim i drejtë publik është një gjykim që në rastin tonë, pra, nuk duhet, një gjykim që duhet të plotësojë standardet minimale. Dhe jemi tani përballë një situate ku nuk po respektojmë parimin kryesor të drejtësisë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Është e rëndësishme për të gjithë personat; jeta e përditshme e njerëzve ngarkohet me këto, domethënë shohim çfarë po ndodh. Ti shkon te berberi; unë shkoj shpesh, por kur shkon te berberi, e sheh në ekran diçka, personat ulen dhe shohim gjykimin. Nuk shkojnë në biblioteka të kërkojnë dokumente online. Jeta e përditshme është kjo: duan të shohim me sytë e tyre çfarë po ndodh, sepse duhet të krijojnë përshtypjen e tyre lidhur me drejtësinë që po kryhet dhe më vjen keq, por unë nuk pajtohem me parashtrimet e ZPS-së.

Unë kam përvojën nga tribunale të tjera. Si qenka kjo më e rrezikshme për personat në Kosovë të dëshmojnë, krahasuar me ata që kanë dhënë dëshminë në TPNJ, kur kanë dhënë dëshmi kundër serbëve apo boshnjakët kundër serbëve, apo serbët kundër serbëve. Ne e kemi përjetuar të gjithë këtë kohë. E kemi kaluar. Disa situata ishin të suksesshme. Më duhet ta them.

Pse qenka kaq e ndryshme situata në Kosovë nga situata në Bosnje e Hercegovinë edhe në Serbi edhe në Kroaci madje, gjatë gjykimeve ku kemi qenë të gjithë pjesë? Unë s'e kam parë këtë. Unë s'kam parë as dëshmi të na e tregojnë këtë. Por bazuar në përvojën kolektive ne mendojmë se situata është ndryshe. Kemi masa kufizuese për dëshmitarë të mbrojtur që s'i ka parë asnjë tribunal tjetër më parë. Unë e kuptoj që disa raste do të kemi masa mbrojtëse. Kanë qenë këto në çdo tribunal, por shkalla e masave mbrojtëse në këtë rast është një pikëpyetje për mua, duke pasur parasysh çfarë kemi parë të gjithë ne në tribunale të tjera përfshirë këtu Ish-Tribunalin e Jugosllavisë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi Smith.

Z. Kehoe, unë do të të tregoj gishtin. Me këto sugjerime ti përmende disa tribunalë të tjerë, sidomos si ka funksionuar TPNJ-ja dhe si e trajtoi këtë aspekt. Unë dua t'ju bëj një propozim: TPNJ-ja a nuk është shembulli më i gabuar deri tani, pas TPNJ-ja pati probleme dhe ne e dimë. Pati probleme serioze sa i takon ndërhyrjes që iu bë dëshmitarëve në disa nga çështjet gjyqësore që madje çuan në apelime, rigjykime e u shprehën një sërë shqetësimesh lidhur me disa nga aktgjykimet që jam i bindur të gjithë i kemi lexuar me kujdes.

Prandaj, unë ju propozoj, dhe po ju pyes më saktë a janë

këto shembujt më të mirë? Sepse këtu po diskutojmë interesa legjitim. Arsyeja pse kjo Gjykatë u krijua në fakt është pikërisht për shkak të problemeve shumë të rënda që ka pasur sa u takon ndërhyrjes së dëshmitarëve. E kuptoj që është kollaj të pretendosh se nuk ka probleme, por në fakt ka. Ka evidenca që tregojnë që ka pasur probleme në TPNJ dhe gjykatat vendase dhe në shumë aktgjykime është shprehur problematike e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve.

Pra, qasja që ne duhet të marrim këtu për të shmangur problemet që pati TPNJ-ja, jo në rastin e Kroacisë apo të Bosnjës, por të Kosovës. Atëherë duhet të veprojmë në të njëjtën mënyrë mendon ti? Apo ta shohim në një këndvështrim pakëz më ndryshe, se mbase jemi pak më të mençur, do të thosha unë. Se këto problemet kanë ekzistuar dhe vazhdojnë të ekzistojnë.

Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, me gjithë respektin, po flasim për TPNJ-në ku jemi rritur unë, ti e të tjerë. Ne po flasim për një çështje kundër një dëshmitari tek i cili pati ndërhyrje dhe aty pati, po, e kuptoj. Ishte një gabim.

Por edhe në gjykatat vendase, juridiksionet nga vijnë ne, ndërhyrja ndaj dëshmitarëve ndodh, ndodh, ndodh edhe në vendet tona. Por mund të trajtohet. Po kaq mbizotëruese qenka kjo? Kaq mbizotëruese qenka kjo saqë TPNJ-ja, domethënë pikërisht situata të TPNJ-së ishte ajo që na e nxiti këtë Gjykatë të

merrte të gjitha këto masa mbrojtëse? Si e masni këtë shkallë? Tek sa dëshmitarë është ndërhyrë në këtë çështje gjyqësore? Tek asnjë, asnjë, absolutisht. Ne kemi qenë në këtë Gjykatë për seancën paraprake për disa vite tani, tashmë. Të gjithë marrim përshtypjet sa i takon atmosferës së rrezikshme në Kosovë, frikësimit të dëshmitarëve edhe i kemi kaluar këtë Gjykatë në një Gjykatë që bën vetëm seanca private.

Unë e kuptoj dhe e mirëpres vlerësimin tuaj. E kuptoj që nuk mund ta garantojmë 100% mosndërhyrjen, por e kemi tepruar shumë. E kuptojmë që ndonjëherë është e nevojshme ta bëjmë, por jemi në një situatë tani që kemi më shumë se 100 dëshmitarë me masa mbrojtëse që i bie, që shumica e këtij gjykimi ose do të jetë në seanca të mbyllura ose në seanca private. Edhe kjo lidhet edhe me komentet e Gjykatës Gaynor, edhe me personat në berberhane që duan ta shikojnë në televizor çfarë po ndodh me drejtësinë, ta krijojmë përshtypjen, të kenë përshtypjen që po shërbehet dhe ka drejtësi, po afrohet drejtësia. Dhe kjo nuk ka për të ndodhur në një situatë të tillë ku ne kemi kaq shumë masa mbrojtëse që janë kaq të shumta gjatë gjithë, për të gjithë dëshmitarët që ne pothuajse për të gjithë dëshmitarët që do të vijnë në këtë Gjykatë.

Uroj t'i jem përgjigjur pyetjes tuaj.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Do të them edhe unë diçka për lidhur me këtë pyetje, sepse ka pasur dy situata në TPNJ të cilat burojnë nga Kosova, pra, ishte gjykimi dhe rigjykimi në

çështjet gjyqësore "Haradinaj". Meqë Gjykatësi Mettraux përmendi kontekstin e Kosovës ma merr mendja që për atë e kishte llafin. Pra, këto ishin dy çështjet ku pati gjykim e rigjykim.

Është shumë e rëndësishme të shohim çfarë ndodhi në këto çështje gjyqësore. Trupi Gjykues herën e parë e shfajësoi z. Haradinaj me arsyetimin se kishte një atmosferë të përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë që janë prova komplet dëshmi apo prova të ndryshme krahasuar me këtë çështje gjyqësore. Por në asnjë rast nuk pati konkretisht frikësim të dëshmitarëve që dhanë dëshmi në atë çështje.

Një dëshmitar vdiq pak para gjykimit dhe u spekulua nëse u hetua siç duhet rasti siç duhet dhe gjykata dhe Prokuroria asaj kohe thanë se ishte një situatë krejt normale. Ishte arrestuar dikush që i jepte, voziste mjetën nën efektin e alkoolit. Dhe gjatë gjykimit ishin dy dëshmitarë që nuk deshën të jepnin dëshmi. Dhe kjo ishte arsyeja që Prokuroria apeloi shfajësimin e personit. Sigurisht, situata në Kosovë ishte relevante, por dhoma e apelit urdhëroi një rigjykim sa i takon një pjesë të aktakuzës për ata dy dëshmitarë. Sa i takon rigjykimit u bënë edhe një herë pyetjet. Madje edhe në distancë ku shkoi e gjithë gjykata për ta zhvilluar seancën nuk pati asnjë pretendim frikësimi për atë çështje gjyqësore apo për asnjë nga dëshmitarët në atë çështje gjyqësore dhe përfundimisht z. Haradinaj u shfajësua përsëri.

Kjo ndodhi nga një tjetër panel ose trup gjyqësor. Ndërkohë, që ka pasur një tjetër diskutim përveç proceseve të brendshme gjyqësore. Domethënë me fjalë të tjera nuk ka absolutisht asnjë provë që ka pasur ndonjë dëshmitar që ka qenë frikësuar, të paktën për procese gjyqësore në një tribunal ndërkombëtar.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I kemi dëgjuar rastet e frikësimeve në procese gjyqësore kombëtare.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, nuk po flas, po, por nuk janë për tribunalet ndërkombëtarë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po le të mos pretendojmë që kjo nuk ekziston.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Pra, jo nuk po mundohem që të mohoj asgjë, por ka këto, domethënë frikësimet kanë të bëjnë me procese gjyqësore në Kosovë. Pra, procese gjyqësore të brendshme dhe jo proceset ndërkombëtare. Megjithatë, pyetje kishte të bënte me TPNJ-në dhe kishte të bënte me procese gjyqësore me aktakuzat dhe me aktgjykimet e nxjerra nga TPNJ-ja. Dhe ju thatë që ishte e qartë nga vendime gjyqësore të TPNJ-së që ka pasur frikësim të dëshmitarëve në procedura gjyqësore në TPNJ dhe unë po them që nuk ka ndodhur kështu. Është tërësisht e gabuar kjo gjë.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Emmerson, nuk ka gjykim sekret këtu; ka një proces gjyqësor që ne të gjithë jemi të interesuar që ky proces gjyqësor të jetë më i hapur seç ka qenë

deri tani. Të gjithë për këtë jemi të interesuar, prandaj po e bëjmë këtë seancë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Thjesht po them një gjë faktike.

GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Jam i sigurt që mund ta formuloni dhe ndryshe. Ndoshta do të duhet të kishit zgjedhur një tjetër fjalë. Nuk është proces gjyqësor sekret, por ne po mundohemi me ndihmën tuaj që ta bëjmë më të hapur, më publik procesin gjyqësor. Dhe thjesht dua të them që nuk ka fare proces gjyqësor sekret këtu.

Z. EMMERSON: [Përkthim] E vlerësoj përshkrimin që bëtë ju i nderuar Gjykatës. Megjithatë, të tjerë, si puna ime, mund të kemi tjetër pikëpamje nga ju.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar] Nuk dua që të tregoj gishtin, por gjithsesi domethënë jam i sigurt që mund ta përballoni këtë situatë.

Z. Emmerson bëri dy propozime disi modeste më përpara. Atëherë do doja që të vlerësonit, le të themi dëshminë e dëshmitarëve. Kemi mbajtur shënim sa i takon fakteve të gjykuara. Nuk duam që të futemi edhe një herë në një diskutim ligjor lidhur me këtë çështje.

Së dyti, duke përdorur një përmbledhje paraprake 154-n dhe që ta shkurtoni goxha pyetjet tuaja dhe me thënë drejtën unë jam befasuar pak që keni përdorur një, pra, rregullën 154, ndërkohë që qëllimi kryesor i rregullës 154 nuk është ky.

Dua që të dëgjoj pikëpamjet tuaj lidhur me propozimin. Nuk

është se do e zgjidhim problemin. Megjithatë, besoj që është e arsyeshme që të dëgjojmë parashtrimet tuaja lidhur me këtë, që gjithsesi mund të keni ndikimin e tyre mbi përmirësimin e situatës.

Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

Nuk do të harxhoj më kohë sa i takon përmbledhjes së proceseve gjyqësore përpara TPNJ-së.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, jepni përgjigje pyetjes që thashë unë.

Z. QUICK: [Përkthim] Sa i takon fakteve të gjykuara ZPS-ja i ka marrë parasysh çështjet dhe faktet të cilat janë të gjykuara dhe përfaqësojnë gjënë e gjykuar. Atëherë besoj që ne i kemi thënë Trupit Gjykues që në qoftë se faktet janë njoftuar atëherë do t'i marrim parasysh atë. Edhe do të marrim parasysh që të ndryshojmë dëshmitarët ose ndoshta të ndryshojmë kohën që kemi parashtruar për marrjen e tyre në pyetje.

Gjykata në vendimin e vet tha që i takon Trupi Gjykues që të pranojë prova, përfshirë këtu edhe gjënë e gjykuar ose faktet e gjykuara apo proceset gjyqësore të mëparshme, përpara TPNJ-së. Dhoma e apelit atje ka konfirmuar disa herë që është në interes të drejtësisë që t'i lejohet ZPS-së dhe Prokurorisë që të parashtrojë prova mbi bazën e fakteve të gjykuara të cilat në fund mund të shkurtojnë kohë, sepse Mbrojtja ka mundësinë që të bëjë pyetje lidhur me këto pyetje ose të miratohen në diskutim. Dhe në atë rast, pra, ZPS-ja mund të

vendosë që të rishqyrtojë atë sërish.

ZPS-ja po i merr parasysh të gjitha këto. Po shqyrton gjithashtu edhe faktin se si faktet ose gjëja e gjykuar mund të përdoret për të përshpejtuar procedurën gjyqësore.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar].

Nuk ka arsye për të mbajtur shënim faktet e gjykuara në qoftë se nuk e përdorni ato për gjëra praktike. Neve duhet që t'i shikojmë këta fjalët që thatë që të kthehen në veprime.

Z. QUICK: [Përkthim] Po, sa i takon dëshmitarëve të cilët kanë dhënë dëshmi për faktet e njëjta të gjykuara, dëshmitarët jo vetëm që japin dëshmi për incidente konkrete, por gjithashtu japin dëshmi edhe --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faktet e gjykuara kanë të bëjnë vetëm me këtë, nuk kanë të bëjnë me gjë tjetër. Ndërkohë që 154 ka të bëjë me tjetër gjë, ka të bëjë me informacion tjetër.

Z. QUICK: [Përkthim] Sa i takon përmbledhjes sipas rregullës 154, ZPS-ja do të japë këto përmbledhje, jo lidhur me dëshmitarin e fundit, por me dëshmitarin më përpara. Besoj që është dhënë një përmbledhje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kishte qenë mirë që të na e kishit thënë paraprakisht se do bëjmë këtë gjë, sepse do e dinim edhe neve, do e dinte dhe Mbrojtja se ne s'e dinim, Mbrojtja s'e dinte. Nuk po them që doni të fshihnit

ndonjë gjë, por në qoftë se do ta bëni këtë gjë, duhet ta bëjmë gjatë gjithë kohës, pra, duhet të kemi të njëjtën qasje.

Z. QUICK: [Përkthim] Po, për sa i takon dëshmitarëve të tjerë që do të merren në pyetje sipas rregullit 154 do ta bëjmë këtë përmbledhje në vazhdimësi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot paradite, për shembull, dëgjuam një dëshmitar që bëri një dëshmi sipas rregullit 154 dhe pastaj kaluan të gjithë dëshminë e tij. Kështu që nuk kishte kuptim që kërkuat, pra, zbatimin e rregullës 154 se sigurisht, domethënë ishte humbje kohe për ne, për ju, për Mbrojtjen.

Z. QUICK: [Përkthim] Unë nuk jam ekspert për dëshmitarin që dëgjuan sot. Megjithatë, me sa kuptova ishte një dëshmi që është nxjerrë drejtpërsëdrejti kishte të bënte me një incident e cila nuk ishte përfshirë tërësisht në të gjithë deklaratën e tij.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kishte shumë hollësi, me thënë të drejtën, që nuk ishin të përfshira.

Z. QUICK: [Përkthim] E kuptoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jam i sigurt që nuk është në dobi të askujt, nuk i bën punë askujt fakti që të mos jepet një përmbledhje sipas [e pakuptueshme] 154 atëherë që e kërkoni një gjë të tillë.

Dëshiroj që të shoh një proces gjyqësor që zhvillohet mbi redaktimet e dëshmive më pas. Edhe sipas përvojës time të më

përparshme, pra, në qoftë se publiku nuk ka mundësi që të kuptojë apo që të lexojë apo të jetë e kuptueshme pjesa e arsyetimit të një aktgjykimi nuk ka vlerë fare e shkruara e gjykimit edhe në qoftë se seancat janë të hapura. Domethënë, sepse në të kundërtën si do ta marr vesh publiku se për çfarë flasim. Dhe ne do të prodhojmë një aktgjykim jo vetëm për të vendosur në qoftë se dikush është fajtor apo jo, por do të rrëfejmë, do të tregojmë që këtë kemi parë, kemi dëgjuar, këtë kemi shikuar me sy tanë. Pra, ta japim në një mënyrë ose gjuhë të kuptueshme. Dhe ka vetëm një mënyrë për ta bërë këtë gjë. Pra, në mënyrë, mënyra është që aktgjykimi të shkruhet në mënyrë të tillë në një mënyrë të kuptimtë. Kështu që ju bëjmë thirrje që ju të bëni punën tuaj në maksimum në mënyrë që këto informacione t'i kemi sa më të saktë të jetë e mundur.

Mendoni, për shembull për ca gjëra që mund të bëjë Mbrojtja, se nuk është e thënë se Mbrojtja gjatë gjithë kohës të bëjë akuza. Nuk varet vetëm nga Prokuroria. Prokuroria është në drejtim tani, por do të ndërroni vendet me Prokurorinë pas ca kohe edhe juve. Kështu që, edhe kontributi juaj do të na ndihmonte goxha.

Atëherë kemi disa çështje të tjera. Përdorimi i kodeve. Mendoj që ndonjëherë është e dobishme që të përdoren kode, mbase nuk të ndihmon po kesh 72 kode, por po të kesh 3, 4, 5 kode të ndryshme që mund t'ia parashtrosh dikujt më përpara, atëherë mund të ketë kuptim. Por çfarë do bëjmë më pas. Pra,

kur i hedhim ato në procesverbal, se kur i përcaktojmë këto kode. Kjo është një pyetje që jua bëj ju tani. Pra, si e bëjmë këtë? E bëjmë në fund të procesit gjyqësor, në fund të dëshmisë së dëshmitarit? Nuk e kemi akoma një përgjigje lidhur me këtë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e di se pse nuk mund të vendoset, nuk mund të sqaroheshim në fillim fare që në fillim, para sesa të japë dëshminë dëshmitari. Nuk e kuptoj arsyen pse nuk mund të vendosen ose specifikohen kodet të tilla.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. EMMERSON: [Përkthim] Në qoftë se e bëjmë në seancë të mbyllur atëherë kjo është për procesverbal. Atëherë është e sqaruar që në fillim fare në procesverbal, se cili kod i përket cilit vendi ose.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di ndonjë prej kolegëve të mi dëshiron që të sqarojë. Ralph, Roche, doni të thoni diçka?

Z. ROCHE nga Zyra Administrative: [Përkthim] Më lejoni të flas diçka lidhur me propozimin në paragrafin 8(iv), në parashtrimin e protokolluar të ZPS-së me referencë 1565.

Ata flasim për përgatitjen e transmetimit publik të seancës së pas bërjes së amendimeve të propozuara. Ne nga Zyra Administrative themi ose parashtrojmë që është shumë e vështirë që të bëhet kjo, për arsye teknike, sepse kemi tri gjuhë

zyrtare dhe ndryshimet në një gjuhë mund të kenë pasoja të ndryshme në gjuhë të tjera. Kështu që do jetë shumë e vështirë që të zbatohet kjo nga pikëpamja teknike dhe mbase mund të ketë edhe dobi shumë të kufizuara. Gjithsesi, në qoftë se keni pyetje të tjera sigurisht që mund t'ju jap shpjegime pasuese.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ekipet e mbrojtjes keni ndonjë pyetje, ndonjë koment?

Z. KEHOE: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë do ta mendojmë dhe një herë. Do të shkruajmë disa ide ose do t'i identifikojmë ca pika kryesore dhe do t'i kalojmë me njëri-tjetrin me palët, pra, këto pika. Shpresojmë që të kemi gjithashtu edhe kontribute prej jush; kontribute krijuese, kritike, qoftë prej Prokurorit, gjithashtu edhe prej palëve të tjera. Pra, ekipeve të Mbrojtjes.

Nuk është gjithmonë faji i njërës pale. E kuptoj që kjo ka dalë në faqen fillim fare, pra, që protokolli i redaktimeve ka ndodhur që në fillim fare të çështjes gjyqësore.

Është përdorim liberal i një pikëpamje konservative do thoja unë. Domethënë, është pak e vështirë që ta trajtosh këtë.

Atëherë, faleminderit shumë për pjesëmarrjen, faleminderit për sugjerimet e mira. Do t'i marrim parasysh dhe do të mundohemi që të marrim një vendim të kuptimtë që do të çojë në përmirësimin e situatës.

E mbyllim seancën për sot.

--- Seanca mbyllet në orën 16.14